



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

---

Nr.883/15 Prot.

Tiranë, më 30/06/2016

**V E N D I M**

**Nr.86, Datë 30/06/2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS,**  
**“REHABILITIMI I ISH- TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NË**  
**PERIUDHËN E TRANZICIONIT”**

Në zbatim të planit vjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas shkresës nr. 883, datë 28.09.2015, njoftim për fillim auditimi dhe shkresave nr. 883/1-3 datë 13.10.2015, nr. 883/4 datë 15.10.2015 njoftim për përfshirjen në auditimin e performancës, ndërmori auditimin e performancës me temë: **“Rehabilitimi i ish- të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit”**.

Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP); Ministria e Mirëqenies Sociale e Rinisë (MMSR) - Drejtoria e Politikave për ish-të Dënuarit e të Përndjekurit; Ministria e Drejtësisë (MD) - Sektori i Trajtimit të Kërkesave për Dëmshpërblimin e ish-të Dënuarve e të Përndjekurve; Ministrinë e Financave (MF) - Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve; këto janë institucionet që kanë për detyrë të propozojnë, ndjekin dhe marrin masat e duhura për rehabilitimin e shtresës së ish-të përndjekurve politikë në vendin tonë. Auditimi u shtri edhe në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me marrjen e të dhënave statistikore në fushën e pensioneve për ish-të përndjekurit politikë.

Instituti i Integritit të ish-të Dënuarve e të Përndjekurve Politikë (IIPP), si institucion në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka për detyrë të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist. IIPP përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me të përndjekurit politikë dhe bashkëpunon me shoqatat e të përndjekurve, duke lidhur për këtë qëllim marrëveshjet përkatëse. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, është përfshirë në këtë auditim në cilësinë e institucionit përgjegjës për bashkërendimin e punës me MD dhe MF për dëmshpërblimin e ish-të Përndjekurve Politikë, përgatitjen e raporteve dhe nismave qeveritare në këtë drejtim. Ministria e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës që ka për detyrë shqyrtimin e kërkesave për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë brenda afateve të përcaktuara dhe, bazuar në ligj, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin

e dëmshpërblimit. Ndërsa Ministria e Financave, sipas buxhetit të vënë në dispozicion të miratuar nga KM, shpërndan, në vlerë, dëmshpërblimin për kategorinë e subjekteve përfituese të ish-të përndjekurve politikë, nëpërmjet çeljes së depozitës bankare, në emër dhe/ose për llogari të tij ose të familjarëve të tij, në një bankë të nivelit të dytë parësore sipas kësteve, të vlerës së planifikuar nga buxheti i shtetit.

Nëpërmjet auditimit të performancës mbi: “Rehabilitimin e ish-të Përndjekurve Politikë në periudhën e tranzicionit”, që zhvillohet për herë të parë në vendin tonë, bëhet një analizë e mirëfilltë për efektivitetin dispozitave ligjore të miratuara për këtë problem dhe zbatimin e tyre në praktikë që nga viti 1991, gjendjen e kësaj shtrese ende të marginalizuar të shoqërisë, rolin e strukturave shtetërore dhe mundësitë e pashfrytëzuara për një rehabilitim sa më të plotë të ish-të përndjekurve politikë, duke dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe rritur vetëdijen e strukturave shtetërore dhe publikut të gjerë për këtë problem thelbësor të shoqërisë sonë.

Në të njëjtën kohë, për herë të parë është audituar lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore nga të gjitha institucionet që ndjekin problematikën e kësaj shtrese, me objektiv rritjen në vazhdimësi të transparencës dhe efektivitetit në rehabilitimin e ish-të përndjekurve politikë. Përveç kërkesave të Rregullores, Manualit të Auditimit të Performancës së KLSH-së, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit - ISSAI, janë kërkuar dhe shfrytëzuar materiale të ndryshme: Plane strategjike dhe studime përkatëse të subjekteve ku është shtrire auditimi, artikuj të medias së shkruar, konkluzione të informacioneve që lidhen me problemin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë, rezoluta dhe raporte të organizatave ndërkombëtarëve, etj. Pavarësisht interpretimit të nevojave për integrimin dhe dinjitet për dhjetëra mijëra të persekutuar, sot ligjëratat politike kufizohen në interpretimin e procesit të rehabilitimit vetëm në një proces të kufizuar të dëmshpërblimit të kategorive të ish-dënuarve e të përndjekurve politikë, copëzuar në këste.

Masat për dëmshpërblimin material përbëjnë veprimet të cilat shpesh ngatërrohen brenda njëri-tjetrit. Rehabilitimi i referohet procesit të rikthimit të një personi në pozitën (personale, profesionale, etj.) që ka patur përpara fillimit të regjimit represiv. Dëmshpërblimi i referohet masave që ofrojnë kompensime të cilat zakonisht marrin formën e paketave të përfitimeve, zhdëmtimeve dhe pagesave të veçanta. Kthimi i referohet dorëzimit të pasurisë së konfiskuar ose të vjedhur pronarëve të saj të ligjshëm apo të pasardhësve të tyre.

Pas përfundimit të punës paraprake audituese me shkresën nr. 883/6 datë 22.02.2016 u dërgua Programi i Auditimit të Performancës. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 883/9, datë 13.05.2016 iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve të audituara. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar komentet dhe shpjegimet e dërguara nga MMSR me shkresën nr. 2907/1 prot. datë 14.06.2016, IIPP me shkresën nr. 422 prot. datë 10.06.2016 dhe MD me shkresën nr. 2907/1 prot. datë 14.06.2016, si dhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe

15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

## KONKLUDOVA:

### **Për Institutin e Integritit të ish të Përndjekurve Politikë, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave:**

Në ligjin e miratuar më shumë se 23 vjet më parë "Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist" ekziston detyrimi ligjor dhe moral i shtetit për zbatimin e ligjit e të drejtën për kompensim dhe fillimisht ligji parashikonte se procesi i kompensimit do të plotësohej në fund të v. 1994. Gjithashtu ligji garantonte lehtësitë dhe përparësitë për kërkesat individuale dhe kolektive në fushat e mëposhtme ekonomike, financiare dhe veprimtaritë sociale: në fushën e privatizimit të pronës shtetërore; dhënies së kredive; ndërtimit dhe strehimit; turizmit arsimimit dhe kualifikimit punësimit brenda dhe jashtë vendit; përmbushjes së programeve të ndryshme ekonomike dhe sociale kombëtare dhe ndërkombëtare; në fushën e shëndetit publik.

Në Rezolutën nr. 1096 të Asamblesë Parlamentare të Evropës, në v. 1996 thuhet:

**"Rreziqet e një procesi tranzicioni të dështuar janë të shumta. Në rastin më të mirë në vend të demokracisë do të mbretërojë oligarkia, në vend të ligjit, korrupsioni dhe në vend të të drejtave të njeriut krimi i organizuar"**

Kuvendi i Shqipërisë, në tetor të vitit 2006, miratoi Rezolutën e vetme në historinë e tranzicionit shqiptar mbi dënimin e krimit komunist, në tekstin e së cilës reflektohen parimet se njohja dhe denoncimi i krimeve të diktaturës komuniste i shërbejnë shmangies së përsëritjes së krimeve të ngjashme në të ardhmen, duke theksuar domosdoshmërinë e ndëshkimit të krimeve të kryera dhe rivlerësimit real të historisë si një faktor vendimtar në edukimin e brezave të rinj.

Çështja e dëmshpërblimit dhe kompensimit pasuror të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, pavarësisht se buron nga ligji 7514, dt. 30.09.1991, i ndryshuar, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", saktësohet dhe rregullohet në mënyrë më të plotë në ligjin "Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist". Ky ligj përcakton nocionin e kompensimit pasuror të këtyre personave si një shpërblim i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim rroge, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t'i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij kur ai ka vdekur, pa kthim, në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve, duke pasur si qëllim kryesor krijimin e kushteve dhe të mundësive për një integrim sa më të shpejtë të tij dhe të familjes së tij në jetën normale ekonomiko-shoqërore të vendit tonë.

Nga krahasimi dhe analiza e realizimit në kohë të masave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, nga neglizhenca në hartimin dhe mosnjerrja në kohë e akteve nënligjore nga organet shtetërore, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet e mësipërme, ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, nuk përfituan plotësisht dhe në kohë nga zbatueshmëria e plotë e kuadrit ligjor, për rrjedhojë janë krijuar pasoja serioze dhe në rehabilitimin e tyre.

Nga institucionet shtetërore përgjegjëse, jo vetëm që nuk janë realizuar detyrimet ligjore ndaj shtresës së ish-të dënuarve, por nuk as një datë të saktë se kur do të mbarojë procesi i

dëmshpërblimit, duke shtyrë kështu për një periudhë të pacaktuar rehabilitimin e plotë të kësaj shtrese..

Aktualisht gëzojnë statusin e ish-të përndjekurit 42.772 persona sipas Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, megjithëse kjo shifër kontestohet nga Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit, sipas të cilit kjo shifër mendohet të jetë dy herë më e lartë (rreth 100 mijë). Si rrjedhojë konstatohet se, duke patur parasysh edhe rrethet familjare të ish-të përndjekurve, i takon të jenë përndjekur direkt afërsisht 30% e popullsisë.

Psikoza e një pjese të shoqërisë së sotme e konsideron si barrë faturën financiare që po dëmshpërblehet, duke lënë në harresë faktin se kjo shtresë ka dhënë një kontribut shumë të madh me ndërtimin e një sërë veprash madhore, si: tharje kënetash, kombine, rafineri, miniera, vepra bujqësore, etj., të cilat zënë peshë në prodhimin e përgjithshëm dhe që akoma sot disa prej tyre janë pasuri kombëtare me vlera ekonomike.

Përqindja e planifikuar për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel shumë të ulët nga të ardhurat e planifikuara në buxhet. Në periudhën 2009-2015, pas daljes së ligjit mbi dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, për çdo vit rezulton të jenë paguar mesatarisht 1,93 miliardë lekë dhe bazuar në përlllogaritjen e bërë nga Ministria e Financave për 13.167 dosje të pranuar dhe të miratuara me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, shoqëria i detyrohet shtresës së ish-të përndjekurve një shumë prej 52,7 miliardë (nga të cilat janë dhënë 16,7 miliardë lekë); me ritmet e pagesës së 7 viteve të fundit (mesatarisht 1,93 miliardë në vit), detyrimi i pa likuiduar prej 36 miliardë lekë do të shlyhej nga qeveria pas 18 vjetësh. Vlera e mësipërme përbën një shumë simbolike, pa folur për shpërblimin për punën e papaguar.

Megjithëse është një proces që ka filluar që në v. 1993, çështja e dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë vazhdon të zvarritet. Ekzekutivi i ka ndryshuar disa herë procedurat duke e ndërlikuar këtë proces dhe përsëri akoma nuk kemi një afat përfundimtar të plotësimit të detyrimit të shoqërisë shqiptare për dhënien e **dëmshpërblimit për ish-të dënuarit e të përndjekurit** dhe trashëgimtarët e tyre.

Tashmë 26 vjet nga rënia e komunizmit ish të përndjekurit politikë kanë përfitur vetë 1/3 e vlerës së dëmshpërblimit për vitet e burgut dhe vuajtjes së përjetuar nën regjimin komunist, që nga ajo kohë vetëm një në gjathtë të përndjekur kanë mbetur gjallë.

Nga të dhënat e IIPP, për ish-të dënuarit e të përndjekurit janë shpërndarë në bono privatizimi: 17.509.637 mijë lekë, që në pjesën më të madhe është një shumë fiktive. Për bonot e privatizimit nuk u arrit synimi i përdorimit të tyre, (jo për fajin e ish-të përndjekurve), vlera e tyre reale u ul në 3-5% të vlerës nominale, vlerë e papërfillshme kjo, gjë që është pranuar edhe nga Qeveria. Janë përdorur vetëm 40% e kësaj shume, të cilat janë shitur në një vlerë shumë më të ulët se vlera e tyre nominale. Prandaj shuma reale në favor të ish-të përndjekurve në letra me vlerë është vetëm 7.614.705 mijë lekë.

Punësimi i ish-të përndjekurve politikë mbetet një ndër problemet aktuale. Gjatë viteve 2013-2015 në fushën e punësimit, IIPP ka mbajtur një korrespondencë intensive me institucionet shtetërore për kthimin në punë të ish-të përndjekurve politikë që janë larguar nga puna me motivacione të ndryshme, duke dërguar rreth 128 kërkesa në gjithë vendin për kthimin e tyre në punë, por vetëm 3 prej tyre janë kthyer në vendin e punës. Vetë IIPP, duke kërkuar respektimin e akteve të administratës nuk merr përgjigje të shkresave zyrtare të dërguara në institucionet përkatëse për problematikën e ish-të përndjekurve politikë si, dëmshpërblimi, arsimit, punësimi, strehimi, bankat e nivelit të dytë, organet e drejtësisë, etj., gjë për të cilat është vënë në dijeni edhe Kryeministri.

Një pjesë e familjeve të kësaj shtrese jetojnë në varfëri dhe në banesat që përdoreshin nga regjimi komunist për të internuarit; varfëria në të cilën ndodhen këto familje nuk u mundëson

atyre as përbalimin e qirasë së banesave sociale.

Për v. 2015 janë 15 ndërmarrjet ekzistuese jobuxhetore shtetërore kombëtare që kanë detyrim derdhjen e fondit të 1% mbi fondin e tyre të pagave, për llogari të Institutit të Integritit ish-të përndjekurve Politikë dhe nuk e kanë plotësuar këtë detyrim ligjor.

Theksojmë se konstatohet mungesa e bashkëveprimit me institucioneve shtetërore që janë të përfshirë në implementimin e ligjit të dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë; mungon një bazë qendrore të dhënash për të kontrolluar në kohë reale gjendjen e dosjeve, llogaritjen e saktë, vendndodhjen dhe mangësitë dokumentare që mund ta shoqërojnë dhe, në disa raste, evidencat kanë shumë mospërputhje.

Megjithëse vazhdimësia mbi ecurinë e procesit të dëmshpërblimit të ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë është deklaruar një prioritet i qeverisë, mungon një strategji për integrimin e saj. Në programin e qeverisë ka vetëm një paragraf që i adresohet kësaj shtrese. Qasja ndaj shtresës së ish-të dënuarve e të përndjekurve ndeshet me indiferencë të dukshme dhe mungesë vullneti politik dhe shtetëror.

Bazuar në sa më sipër, KLSH është përpjekur t'i japë përgjigje pyetjes: **“A i ka shërbyer rehabilitimit të plotë të ish-të përndjekurve politikë, kuadri ligjor i miratuar dhe masat e marra për këtë qëllim gjatë periudhës së tranzicionit ?”**, duke konsideruar veçanërisht të drejtat e kësaj shtrese bazuar në aktet ligjore e nënligjore dhe zbatimin nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse, duke arritur përfundimisht në këtë mesazh auditimi:

**“Kquadri ligjor i miratuar dhe masat e marra nga Ekzekutivi në periudhën e tranzicionit për Rehabilitimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë në vendin tonë i kanë arritur pjesërisht objektivat, nuk kanë siguruar plotësisht dhe kanë dështuar në rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë në një kohë optimale. Dispozitat ligjore kanë qenë të fragmentarizuara dhe jo gjithëpërfshirëse, burimet financiare të pamjaftueshme dhe ka munguar bashkëpunimi i duhur e koordinimi i punës së institucioneve shtetërore për t'i ardhur në ndihmë ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë. Shoqëria shqiptare i ka mundësitë për dëmshpërblimin material dhe rehabilitimin e arsyeshëm të këtij grupi shoqëror në një kohë optimale, duke iu përgjigjur kështu detyrimeve ligjore dhe atyre të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare, që ka marrë përsipër me vendosjen e shtetit të së drejtës, për mbylljen e kësaj plaje shoqërore në vëndin tonë”**.

Çështja e rehabilitimit të ish- të dënuarve e të përndjekurve politikë nuk ka ecur me ritmet e duhura si në drejtëm të hartimit, miratimit dhe zbatimit të ligjshmërisë, bashkëpunimin e institucioneve për zbatimin e detyrave të përcaktuara me ligj në fushën e zgjidhjes së problemeve me të cilat ndeshen në jetën e përditshme ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë, bazuar në faktin se zbatimi në praktikë ka lënë shumë për të dëshiruar **për arsye se dëmshpërblimi po zgjatet jashtë çdo limiti**.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar adresimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij problemi social:

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Performancës, “Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit”, të ushtruar në Institutin e Integritit të ish-

të Përndjekurve Politikë; Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

**A. – Në drejtim të hartimit të dokumenteve strategjike:**

1. Ngritjen e një grupi pune nën drejtimin e IIPP, ISKK dhe MMSR-së, me pjesëmarrjen e MD dhe MF, për përgatitjen e një materiali studimor në bazë të të cilit t'i propozohet Kuvendit të Shqipërisë një strategji kombëtare që do të krijojë mundësi reale të hartimit dhe zbatimit të politikave për rehabilitim moral, dëmshpërblim solidar financiar dhe për shërbimet publike prioritare, përfshi ato shoqërore në favor të shtresës së ish-përndjekurve dhe familjeve të tyre, si edhe për të mos lënë në harresë këtë periudhë të errët të shoqërisë shqiptare.

*Brenda v. 2016*

**B. – Në drejtim të efektivitetit të implementimit të kuadrit ligjor dhe rregullator:**

2. **Instituti i Integritit të ish-të përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të ndërmarrin hapat e nevojshëm:**

- a) Për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe harmonizimit të punës ndërmjet organeve shtetërore, për zbatimin e detyrimeve ligjore në drejtim të rehabilitimit të ish-të përndjekurve politikë.

*Në vijimësi*

- b) Për **ngritjen e një bazë të dhënash elektronike të koordinuar (regjistri kombëtar)**, për çdo ish-të dënuar e të përndjekur, që do mundësonte në kohë reale informacionin e përditësuar për të gjithë organet shtetërore, hartimin e prognozave të vlefshme dhe efektet financiare të politikave të ndryshme që do të ndiqen, etj., **si dhe ky regjistër të jetë transparent për publikun e gjerë.**

*Brenda v. 2016*

- c) Përfaqësuesit e kësaj shtrese, të gjithë veprimet me organet shtetërore, **t'i kryejnë në një zyrë (one stop shop)** për t'i dhënë fund fragmentimit të shërbimeve në lidhje me dokumentimin e statusit të ish-të përndjekurve, procedurës së dëmshpërblimit financiar, shërbimeve juridike, të integritit, etj.

*Brenda v. 2016*

3. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave, të kërkojnë shtimin e fondeve për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, duke mundësuar shlyerjen e këtij detyrimi të shoqërisë

- a). Brenda vitit 2017 për dosjet e ish-të përndjekurve politikë që janë dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë në vitet 2007 – 2008;

- b). Brenda vitit 2018 për aplikimet e ish-të përndjekurve politikë të dorëzuara pas vitit 2008 në Ministrinë e Drejtësisë.

- për këtë dhe 20% të të ardhurave nga privatizimi i sektorëve strategjikë të shkojë për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë; rekomandim ky i lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit që në vitin 2012.

*Gjatë v. 2017*

4. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për forcimin e rolit të IIPP në shërbim të shtresës së ish-të përndjekurve politikë, të kërkojë rritjen e fondeve vjetore të këtij institucioni, në një shumë sa pësëfishi i fondeve vjetore të akorduara deri tani.

*Për v. 2017 dhe në vijim*

5. Nga **Ministria e Financave**, në zbatim të ligjit për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë, të hartohet një udhëzim konkret për përcaktimin e formave të pagesës për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, duke përcaktuar në mënyrë konkrete gjithë operacionet e domosdoshme për kryerjen e pagesave, si dhe rregullat e nevojshme mbi procesin, autoritetin përkatës të kryerjes së veprimeve dhe autoritetin kontrollues, duke përcaktuar dhe riskun për çdo operacion pune.

*Deri në fund të v. 2016*

6. Nga **Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve** e MF, në bashkëpunim me IIPP, të merren të gjitha masat organizative për të saktësuar të gjitha dosjet e përfituesve të shpallura me VKM, në mënyrë që të mos të kalojnë periudha 3-vjeçare e pagesës së këstit të parë për mungesë të mosplotësimit të dokumentacionit nga përfituesit.

*Brenda muajit Tetor 2016*

7. **Ministri i Financave** të marrë masat e nevojshme për konsolidimin e stafit të Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve dhe të miratojë detyrat funksionale të drejtorisë ku të formalizohen dhe të përcaktohen qartë rregullat e komunikimit, raportimit dhe monitorimit.

Mundësisht shumica e stafit të jenë nga kjo shtresë, çka do të bënte të punonin me përkushtim më të madh.

*Menjëherë*

8. Ministri i Financave të marrë masa organizative për **vënien në eficiencë të programit** të ri elektronik të pagesave, trajnimin e punonjësve të Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve për përdorimin e tij dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për situatën dhe mangësitë e konstatuara në punën e kësaj drejtorie.

*Menjëherë*

9. Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve të marrë menjëherë masat për kryerjen **rakordimeve mujore dhe progresive** me bankat e nivelit të dytë, MMSR dhe me Thesarin lidhur me dëmshpërblimet e akorduara për ish-të përndjekurit politikë.

*Menjëherë*

10. Ministria e Financave të hartojë sa më parë dhe ta dërgojë për shqyrtim në Kuvend, **raportin mbi** mënyrën e shpërndarjes së dëmshpërblimit për **v. 2015**, në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore.

*Menjëherë*

11. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë t'i propozojë qeverisë nxjerrjen e akteve nënligjore ku, **në procesin e kthimit dhe kompensimit të trajtohen me përparësi** qytetarët që gëzojnë statusin e ish-të përndjekurit politik, si dhe të parashikohet edhe

kompensimi në raste e shkatërrimit apo dëmtimit të pronave të ish-të përndjekurve për arsye politike.

*Brenda v. 2016*

**12. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë të ideojë dhe të propozojë ndryshimet e duhura ligjore, si dhe të ndjekë zbatimin e politikave nxitëse për **strehimin, arsimimin dhe punësimin e shtresës së ish-të përndjekurve politikë:****

- a) MMSR dhe IIPP të marrin masat për evidentimin sipas njësive administrative të të gjitha familjeve të pastreha të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë dhe, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, të kërkohet dhe të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme **trajtimi me strehim i tyre me përparësi.**

*Në vijimësi*

- b) MMSR dhe IIPP, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, të studiojnë çdo vit akademik shkollor nevojat dhe për plotësimin e tyre **të caktohen kuota të veçanta për fëmijët e familjeve të ish-të përndjekurve politikë.**

- c) MMSR të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative pranë organeve përkatëse shtetërore dhe të kërkojë **kthimin në punë për punonjësit e larguar padrejtësisht të cilët vijnë nga shtresa e ish-të përndjekurve politikë.**

**IIPP të plotësojë dosjet me parregullsitë për largimet nga puna të kësaj shtrese dhe t'i ndjekë ato në Gjykata deri në ripunësimin e tyre.**

- d) MMSR dhe IIPP të bëjnë regjistrimin e të gjithë punonjësve që rrjedhin nga shtresa e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, të cilët punojnë në sektorin publik.

- e) MMSR të propozojë në Këshillin e Ministrave **caktimin e një kuote të detyrueshme në të gjitha subjektet e sektorit për punësimin e qytetarëve që gëzojnë statusin e ish-të përndjekurit politik apo familjarëve tyre, të cilët plotësojnë kriteret e arsimit, kualifikimit, vjetërsisë në punë, etj.**

*Brenda v. 2016*

**13. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, të bashkërendojnë punën dhe të marrin masat që të gjitha ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore për çdo vit ushtrimor buxhetor të plotësojnë **detyrimin ligjor për derdhjen 1 % të fondit të pagave në buxhetin e IIPP.****

*Në vijimësi*

**C.- Në drejtim të hartimit dhe rishikimit të kuadrit ligjor e rregullator në Rehabilitimin e ish-të Dënuarve e të Përndjekurve Politikë:**

1. **Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, në draftin e projekt/ligjit për ndryshime të Ligjit nr. 9831 dt. 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist”, të llojë me grupet e interesit për të hedhur për diskutim në Kuvendin e Shqipërisë çështjet e mëposhtëme:**

- a) Të bëhen rregullimet e duhura ku efektet për **dëmshpërblim financiar** të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë **të shtrihen nga muaji gusht 1943**, njohur si prishja e Marrëveshjes së Mukjes, kohë kur filloi vëllavrasja në Shqipëri dhe janë vrarë njerëz pa gjyq në jug e veçanërisht në veri apo në dy javët e para të muajit nëntor të vitit 1944 në Tiranë.

- b) Për personat, të cilët për periudhën kohore të vuajtjes së dënimit apo internimit në kampe me rrethim me tela me gjemba, etj., të cilët kanë fituar statusin e ish-të përndjekurit politik, kur mungon dokumentacioni nga Arkivi i Drejtorisë së Burgjeve, **të njihet koha e vuajtjes së dënimit e vërtetuar me vendimin e Komisionit Shtetëror Tre Palësh**, apo vendimin e vërtetimit të faktit të gjykatës.

*Menjëherë*

2. Në zbatim të nenit 118 të Kushtetutës dhe ligjit për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, nga MMSR, në bashkëpunim me MD, MF dhe ISSH, të hartojnë dhe propozojnë Këshillit të Ministrave, **projektvendimin për skemën e pensionit të ish të internuarve dhe të dëbuarve.**

*Brenda vitit 2016*

Raporti i Auditimit të Performancës “**Rehabilitimi i ish- të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit**” dhe Vendimi me rekomandimet, t’i përcillen Kryetarit të Kuvendit, Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Komisionit të Ekonomisë dhe Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të Kuvendit  
Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**